



Arrestohet një person i dyshuar për vjedhje të rëndë dhe armëmbajtje pa leje

• 2 vjet më parë



MË TË LEXUARAT TË FUNDIT

1. Avokati i Qeverisë: VV po e sfidon vendimin e Gjykatës që s'ia mori të drejtën për t'u zgjedhur Etem Arifit
2. Murati kritikon Gjykatat për mosinformimin e Kuvendit lidhur me rastin e deputetit Arifi
3. Kryesia e LDK-së bën homazhe tek varri i Rugovës, Haziri: Pa LDK-në nuk ka zgjedhje dhe as zgjidhje
4. Vetëvendosja kërkon që Kushtetuesja ta shpallë të pavlefshme votën e Arifit
5. Vdes dy vjeçarja në Skënderaj
6. Vdes doganieri 47-vjeçar nga COVID-19
7. Foshnja 9 muajshe në mesin e pesë viktimave në Gjermani pasi vetura goditi këmbësorët
8. Posta e shpejtë mashtroi firmat, ua mori paratë e porosive (VIDEO)
9. Fushë Kosovë: Gruaja rrah burrin me kablllo



Njësiti i Hetimeve të Përgjithshme në Prishtinë, i përkrahur edhe nga Njësiti Special Operativ, konform urdhëresës së lëshuar nga Gjykata themelore, ka ndërmarrë një operacion bastisjeje në fshatin Gollubovc të Malishevës, ku është bërë bastisja e tre lokacioneve të ndryshme si dhe arrestimi i një personi të dyshuar për vjedhje të rëndë.

Ky operacion bastisjeje ka ardhur si rezultat i një pune operative dhe hetimore që hetuesit policor kanë bërë lidhur me identifikimin dhe kapjen e personave të inkriminuar në një rast të vjedhjes së rëndë që ka ndodhur në nëntor të vitit 2018 në fshatin Dobroshevc të Drenasit, transmeton Klan Kosova.

“Operacioni i bastisjes ka rezultuar me gjetjen dhe sekuestrimin e një arme automatike AK 47, dy karikatorëve, 23 fishekëve si dhe dëshmi të tjera që mund të ndërlidhen me një rast vjedhje”.

“Ndërsa personit të dyshuar i cili është 37 vjeçar i është shqiptuar masa e ndalimit dhe i njëjti është dërguar në qendrën e mbajtjes, ndaj tij po ashtu është iniciuar rasti për mbajtje në pronësi,